

korrik 2010

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

- Propozimet e Kuvendit inkorporohen në Strategjinë për Privatizimin e PTK
- Qeveria akrediton Universitetin e Prishtinës dhe shumicën e BPrAL-ve
- Strategjia Legjislative 2010 në shtatë mujorin e zbatimit të saj
- Miratohet Projektligji për Tregtinë e Mallrave Strategjike



Gjatë muajit korrik Qeveria e Kosovës ka mbajtur 4 mbledhje ku janë marrë 31 vendime ekzekutive. Pesë nga këto vendime ekzekutive kanë të bëjnë me miratim të projektligjeve, 3 vendime për miratim të udhëzimeve administrative, 5 vendime për emërim të anëtarëve ne borde të ndërmarrjeve publike, agjencione dhe këshilla; 2 vendime për shpronësim të pronave për autostradën Vërmicë-Merdare; etj.

Një nga vendimet më të rëndësishme gjatë këtij muaji është vendimi i Qeverisë për vazhdimin e procesit të privatizimit të PTK, duke marrë për bazë edhe sugjerimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Strategjia për Privatizimin e PTK pritet që sërish të debatohet në Kuvendin e Kosovës në njërën nga seancat e sesionit vjeshtor.

Përkundër miratimit të pesë projektligjeve nga Strategjia Legjislative 2010, edhe më tutje Qeveria e Kosovës mbetet shumë mbrapa afateve kohore të parapara për miratim të projektligjeve sipas Strategjisë Legjislative.

Në brendi të këtij numri të GAP Monitor mund të informoheni më në hollësi për të gjitha vendimet e marra gjatë muajit korrik 2010.

Përmbajtja:

1. Propozimet e Kuvendit inkorporohen në Strategjinë për Privatizimin e PTK
2. Qeveria akrediton Universitetin e Prishtinës dhe shumicën e BPrAL-ve
3. Strategjia Legjislative 2010 në shtatë mujorin e zbatimit të saj
4. Miratohet Projektligji për Tregtinë e Mallrave Strategjike
5. Miratohet Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020
6. Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës
7. Qeveria i propozon Kuvendit Bordin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit
8. Qeveria miraton Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës
9. Bordi i Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave bëhet me anëtarë të rinj
10. Qeveria ndan mjete për subvencionimin e bujqve dhe për TMK-në
11. Merret iniciativë për themelimin e Qendrës për Studime dhe Hulumtime Gjimore
12. Universiteti i Prizrenit lejohet të shpallë konkurs për pranimin e studentëve të rinj
13. Qeveria ende e pa vendosur si t'ia bëjë me prokurorim publik
14. Shpronësimi i pronave për ndërtimin e autostradës vazhdon në Komunën e Suharekës
15. Miratohet Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë
16. Miratohet Projektligji për Markat Tregtare
17. U miratuan tri udhëzime administrative në kuadër të Ligjit për Menaxhimin e Integruar Kufitar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror
18. Miratohet Koncepti i Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike
19. Emërohet këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve
20. MFSK dhe FSK me strukturë të re
21. Është miratuar Plani i Veprimit të Strategjisë për Rikthimin e Personave të Riatdhesuar

Propozimet e Kuvendit inkorporohen në Strategjinë për Privatizimin e PTK

Strategjia për Privatizimin e PTK do të shqyrtohet sërish në Kuvendin e Kosovës gjatë muajit shtator

Privatizimi i Postës është temë që ende vazhdon të bëjë bujë dhe vazhdimisht përcillet me shumë kritika. Që nga marrja e vendimit për privatizimin e saj më 13 tetor 2008 (Vendimi nr. 02/41), kur edhe themelohet Komisioni Ndërmënyor, punët mbetën pezull deri në nëntor të vitit 2009 kur Komisioni Ndërmënyor filloi punën për të analizuar dhe për të bërë rekomandime për pjesëmarrjen e sektorit privat në PTK, e njëherazi edhe hartimin e strategjisë për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. Këto vonesa vunë edhe një herë në dyshim mendimin nëse privatizimi i PTK-së po udhëhiqej drejt dhe sa a do të jetë i suksesshëm.

Raporti për Strategjinë e Privatizimi, i përgatitur nga Konsorciumi Telco AG dhe Wolf Theis GmbH analizon dhe vlerëson tregun e PTK-së dhe opsionet e privatizimit. Ky komision propozon fillimisht 4 opsione të privatizimit dhe 3 forma të strukturës së transaksionit, të cilat pas vlerësimeve të mëtutjeshme nga komisioni janë zvogëluar në 2 opsione, të dhëna si rekomandim për privatizimin e PTK-së. Opsioni i parë ishte shitja e 67% të aksioneve, ndërsa opsioni i dytë shitja e 100% të aksioneve. Pas rekomandimeve të bëra nga komisioni, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 130-të të datës 16 qershor 2010, merr vendimin që të privatizohen 75% e aksioneve të PTK-së, duke i lënë Qeverisë në dispozicion 25% të aksioneve, e cila do t'i mundësonte asaj disa të drejta bllokuese në bordin e menaxhmentit.

Vendimi i Qeverisë u përcoll me shumë kritika të cilat u bënë të qarta edhe gjatë seancës plenare në Kuvendin e Kosovës të datës 27 korrik 2010. Kështu grupi parlamentar i AAK-së nuk e kanë dhënë mbështetjen dhe shumica e deputetëve të AAK-së, AKR-së dhe LDD-së nuk morën pjesë në mbledhje. Megjithatë, Kuvendi miratoi në parim propozim-strategjinë e Qeverisë për privatizimin e PTK-së dhe ngarkoi Qeverinë që vërejtjet dhe sugjerimet t'i inkorporojë në draftin final të strategjisë.

Pas këtij vendimi të Kuvendit në mbledhjen e 135-të të Qeverisë të datës 28 korrik merret vendim që të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e dala nga mbledhja e Kuvendit të inkorporohen në strategjinë e privatizimi. Disa ndër vërejtjet dhe rekomandimet ishin që të mos përshpejtohet procesi i privatizimi, meqenëse nevojiten sqarime plotësuese rreth mënyrës së privatizimit; të diskutohet dhe të përcaktohet në mënyrë të detajuar fati i punëtorëve; u propozua të zhvillohen më shumë konsultime me ekspert të ndryshëm dhe të merren parasysh përvojat e vendeve tjera.

Se sa janë marrë për bazë këto vërejtje dhe si do të mbajë qëndrim opozita na mbetet ta presim shtatorin, kur kjo strategji do të del sërish për rivotim në mbledhjen e kuvendit.



Qeveria akrediton Universitetin e Prishtinës dhe shumicën e BPrAL

Pas rekomandimeve që i kishte bërë Agjencioni Kosovar i Akreditimit (AKA) Ministrisë së Arsimit për akreditimin apo mos akreditimin e programeve brenda Universitetit të Prishtinës dhe Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, Qeveria ka dhënë fjalën e fundit për akreditimin apo mos akreditimin e këtyre programeve. Në mbledhjen 134 të mbajtur më 14 korrik, përmes vendimit 04/134 Qeveria akreditoi shumicën e programeve studimore në Universitetin e Prishtinës. Programet të cilat nuk u akredituan në UP, janë: Studimet Master në drejtimin “Historia e Mesjetës e Ballkanit”, studimet MA për Fizioterapi, studimet MA për Trafik dhe Transport, studimet MSc për Agroekonomi dhe ato për Mbrojtje të Bimëve, studimet bachelor dhe master për “Letërsi e përgjithshme dhe krahasimtare”, studimet master për gjuhë dhe letërsi turke dhe gjermane, si dhe studimet master në Industrinë e Drurit. Përveç këtyre programeve, të gjitha programet tjera të UP, apo 113 programe, janë akredituar, kurse me kusht për një vit janë akredituar 8 programe.

Procesit të akreditimit i janë nënshtruar gjithsej 15 fakultete të Universitetit të Prishtinës, ndërkaq dy fakultete e mbetura Fakulteti Xehtaro Metalurgji dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike janë në proces të akreditimit. Akreditimi zgjat 3 vite, përveç kur është precizuar ndryshe.

Ndërkaq, me vendim 05/134, Qeveria e Kosovës ka kredituar 18 nga 21 BPrAL që i ishin nënshtruar sivjet procesit të akreditimit. Nga ta 10 janë akredituar si kolegje, 6 si shkolla të larta dhe 2 si institute. Vitin e kaluar Qeveria kishte akredituar 12 BPrAL. Megjithatë, edhe sivjet asnjë nga këto institucione nuk mund të bartë emrin universitet e as nuk mund të jap tituj akademik për mësimdhënësit apo të ofrojë studime të doktoraturës.

Për listën e plotë të programeve të akredituara, atyre të akredituara me kusht dhe programet e paakredituara në Universitetin e Prishtinës, si dhe BPrAL të akredituar, vizitoni uebsajtin e GAP Monitor apo <http://gapmonitor.org/?id=2&n=101>.

Strategjia Legjislative 2010 në shtatë mujorin e zbatimit të saj

Universitetit të Prishtinës i akreditohej 113 programe, gjersa nuk i akreditohej 9 programe

Strategjia Legjislative e Qeverisë së Kosovës për vitin 2010, e cila deri në fund të qershorit përmbante 128 projektligje, ka pësuar disa ndryshime në muajin korrik. Gjatë këtij muaji, Qeveria e Kosovës me tri vendime të ndryshme ka ndryshuar strategjinë legjislative, duke hequr dhe shtuar projektligje në strategji. Nga Strategjia Legjislative (SL'10) është larguar Projektligji për Kontrollin e Eksportit, kurse janë shtuar tri projektligje: Projektligji për Prokurorim Publik, Projektligji për Qendrën e Kosovës për Siguri Publike dhe Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Policinë. Me këto ndryshime, tani SL'10 përmban 130 projektligje.

Gjatë muajit korrik janë miratuar 5 projektligje. Numri i projektligjeve të miratuara në periudhën janar-korrik 2010 ka arrit në 39 projektligje. Në krahasim me numrin e projektligjeve në SL'10, Qeveria e Kosovës ka arrit të miratojë vetëm 30% të Strategjisë Legjislative.

Miratohet Projektligji për Tregtinë e Mallrave Strategjike

"Mallra strategjik" nënkuptojnë mallrat të cilët për shkak të sigurisë dhe marrëveshjeve ndërkombëtare bëhen të tillë, siç janë mallrat ushtarake, mallrat e përdorimit të dyfishtë dhe të tjera, të cilat emërtohen të tilla për shkak të përdorimit apo përdoruesit të fundit

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 132-të, ka miratuar Projektligjin për Tregtinë e Mallrave Strategjike. Me anë të këtij projektligji synohet të rregullohet veprimtaria e institucioneve shtetërore në fushën e eksportit, importit dhe transitit të mallrave dhe shërbimeve strategjike. Për më tepër, ky projektligj rregullon kontrollin, mbikëqyrjen, të drejtat dhe detyrime e palëve pjesëmarrës në aktivitetet e biznesit në fushat e lartpërmendura. Termi "mallra strategjik" nënkupton mallrat të cilët për shkak të sigurisë dhe marrëveshjeve ndërkombëtare bëhen të tillë, siç janë mallrat ushtarake, mallrat e përdorimit të dyfishtë dhe të tjera, të cilat emërtohen të tilla për shkak të përdorimit apo përdoruesit të fundit.

Projektligji për tregtinë e mallrave strategjike parasheh formimin e një komisioni, i cili do të përcaktojë dhe menaxhojë licencat e dhëna për eksport, import, shërbime dhe transit të mallrave strategjike. Këto licenca jepen ndaras për çdo mall dhe kanë afat kohor deri në 6 muaj, përpos nëse

është e përcaktuar ndryshe. Komisioni gjithashtu do të përcaktojë edhe klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve strategjike. Ky komision përbëhet nga 5 anëtar; përfaqësues të MTI (njëherazi edhe institucioni përgjegjës), MPJ, FSK, MEF dhe MPB.

Qeveria, me propozim të Ministrisë përkatëse, duhet të miratojë vendimin për përpilimin e listës së mallrave dhe shërbimeve strategjike në pajtim me listën e BE-së. Parakusht për marrjen e licencës së eksportit apo importit të mallrave strategjike është regjistrimi në regjistrin e eksportuesve apo importuesve të mallrave strategjike. Personat të cilët merren me eksport/import të këtyre mallrave janë të obliguar të mbajnë regjistra të veçantë për transaksionet e kryera, së paku 20 vjet pas përfundimit të aktivitetit. Projektligji parasheh gjobë prej 10.000 – 50.000 euro ose 1-5 vjet burg për kryerjen e aktiviteteve pa licencë, ndërsa nëse kryhet ndonjë vepër penale me armët e eksportuara/importuara dhe shkaktohet vdekja e ndonjë personi burgimi mund të zgjasë deri në 15 vjet.



Miratohet Plani Hapësinorë i Kosovës 2010-2020

Në mbledhje 134, Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimi 01/134, miratoi Planin Hapësinorë të Kosovës 2010-2020. Ligji për Planifikimin Hapësinor përcakton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si subjekt përgjegjës për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës. Plan Hapësinor 2010-2020 është plotësim i draft – dokumentit Plan Hapësinor i Kosovës 2005-2015+, i cili u aprovua në parim në Kuvendin e Kosovës në Janar 2007. Për shkak të ndryshimeve politike, të cilat kanë sjellë ndryshime të tjera hapësinore, ka qenë e domosdoshme ndërmarrja e aktiviteteve shtesë për harmonizimin dhe plotësimin e tij.

Planifikimi hapësinor është planifikimi i hapësirës fizike e cila na rrethon: hapësira ku janë të ndërtuara shtëpitë tona, hapësira në zonën urbane dhe rurale, hapësira në të cilën janë vendet tona të punës, hapësirat e rrugëve, infrastrukturës dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Ky Plan Hapësinor i Kosovës është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht të mbrojtë resurset, trashëgimin natyrore dhe kulturore. Ky Plan Hapësinor do të:

- Udhëzojë sektorët dhe agjencitë e qeverisë në hartimin dhe implementimin e politikave dhe vendimeve për investime publike të cilat kanë dimension të theksuar hapësinor ose mund të ndikohen nga hapësira;
- Udhëzojë aprovimin e politikave lidhur me investimet strategjike në infrastrukturë, posaçërisht në transport dhe telekomunikime; udhëzojë politika lidhur me vendosjen e zhvillimit të industrisë, banimit, shërbimeve, zhvillimit rural, turizmit dhe trashëgimisë natyrore e kulturore;
- Përkrahë zhvillimin e balancuar në mes të zonave të zhvilluara dhe zonave me zhvillim ekonomik më të ulët;
- Përcaktojë lokacionet strategjike të cilat do t'i favorizonin jo vetëm zonat urbane por edhe ato rurale;
- Identifikojë rolin e qyteteve kryesore në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor të Kosovës;
- Po ashtu, plani hapësinor duhet të jetë udhëzues në hartimin e planeve të tjera zhvillimore – komunale dhe lokale;
- Vendosë principe të praktikës së mirë të planifikimit hapësinor, për të mundësuar që vendosja e popullsisë, punësimi dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore t'i shërbejë më së miri zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe kualitetit më të mirë të jetës.

Edhe pse dokument me rëndësi për tu konsultuar nga të gjithë qytetarët e Kosovës, Plan Hapësinor 2010 – 2020 ende nuk është publikuar në asnjë adresë elektronike të Qeverisë së Kosovës. Përgjegjës për publikimin e tij është MMPH dhe Instituti për Planifikim Hapësinor.

Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të 134-të miratoi Projektligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Me këtë Ligj parashihet që të rregullohet sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës dhe vlerave të sajë. Sipas nenit 2, ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të sajë dhe veçanërisht:

- mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
- përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;
- pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre;
- sigurimin e të drejtës së publikut për informim për

gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;

- sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;
- mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Komunitetin;
- ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve te cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

Mjetet për financimin e mbrojtjes së natyrës sigurohen nga shfrytëzimi i të mirave të natyrës dhe vlerave të mbrojtura të natyrës nëse me këtë Ligj ose me ndonjë ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe, kompensimet nga dhënia me koncesion dhe nga burime tjera të përcaktuara me ligj ose dispozitat e nxjerra në bazë të ligjit.

Qeveria i propozon Kuvendit anëtarët për Bordin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit

Qeveria propozon edhe për një mandat shtesë anëtarët aktual të Bordit të AKP

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e saj të 134-të me vendimin 03/134, për anëtar të Bordit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit i propozoi Kuvendit të Kosovës këta kandidatë: Z. Dino Asanaj, Z. Slobodan Petrovic, Z. Haxhi Arifi, Z. Bahri Shabani, edhe Z. Naser Osmani, i cili ishte propozuar për anëtar të Bordit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me vendimin e Qeverisë Nr.03/117, të datës 30 mars 2010.

Vlen të përmendet se dy vite më parë, në mbledhjen e 25 të Qeverisë së Kosovës më 3 korrik 2008, Qeveria i kishte propozuar Kuvendit këta kandidat për anëtar të bordit të AKP: Dino Asanaj, Haxhi Arifi, Slobodan Petroviç, Fadil Ferataj dhe Bahri Shabani. Pas vdekjes së Fadil Feratit, Qeveria kishte propozuar z.Naser Osmani, për zëvendësim të postit vakant në bord të AKP. Tani edhe një herë Qeveria e Kosovës u ka vazhduar mandatin të gjithë anëtarëve të bordit të AKP edhe për një mandat dy vjeçar.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose

shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. Agjencia është themeluar si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”.

Bordi përbëhet nga tetë Drejtorë, duke përfshirë edhe Drejtorin Menaxhues dhe i ka të gjitha kompetencat e Agjencisë. Kuvendi i Kosovës ka për detyrë të emërojë pesë drejtorë, duke përfshirë një përfaqësues nga një komunitet jo – shqiptar si dhe Kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, dhe të përcaktojë njërin nga të emëruarit që të shërbejë si Kryesues i Bordit. Ndërsa, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar ka për detyrë të emërojë tre ndërkombëtarë si Drejtorë të Bordit dhe një ndërkombëtar si Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit. Drejtorët, përveç kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Bordit si dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit emërohen me mandate të përsëritshme dyvjeçare. Bordi ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë dhe për përmbushjen e kësaj përgjegjësie ndërmerr veprimet e duhura apo të lejuara me ligj.



Qeveria miraton Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës

Me këtë projektligj përcaktohen misioni, organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor të Kosovës, si agjencion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Me vendimin 05/132, Qeveria ka miratuar edhe Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK). Arsyeja për nxjerrjen e një projektligji të ri lidhur me veprimtarinë e Inspektoratit Policor të Kosovës është krijimi i një autoriteti jashtë Policisë së Kosovës, i cili përveç kompetencës inspektuese mbi Policinë e Kosovës do të jetë përgjegjës edhe për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës brenda ose jashtë saj. Me këtë projektligj përcaktohen misioni, organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor të Kosovës, si agjencion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në Nenin 6 të këtij projektligji, shpjegohet se si IPK është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të

Brendshme, e pavarur nga Policia e Kosovës dhe në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit. IPK po ashtu funksionon nën autoritetin e Ministrit dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit të IPK-së, i cili është autoriteti ekzekutiv apolitik në kuadër të IPK-së dhe autoriteti më i lartë administrativ, teknik dhe operacional i saj.

Ky projektligj gjithashtu shpjegon veprimtaritë e IPK duke siguruar një polici të përgjegjshme, demokratike dhe transparente që bënë parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e policisë së Kosovës; inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës më qëllim që të sigurohet llogaridhënia, efektiviteti dhe efikasiteti në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standard; hetimi ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit

e Policisë së Kosovës; hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv, përveç Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë; pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës.

IPK e ka buxhetin e vet të ndarë nga MPB dhe që është objekt auditimi. Kryeshefi ekzekutiv i IPK-së është përgjegjës për menaxhimin efektiv dhe të drejtë të buxhetit të miratuar. Buxheti i aprovuar për vitin 2010 për IPK-në është 622.351 euro, ndërsa kostoja shtesë buxhetore për periudhën 2011 -2013 vlerësohet në shumë totale prej 5.113.500 euro.

Bordi i Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave bëhet me anëtarë të rinj

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 132-të, ka miratuar propozimet për emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave. Emrat e propozuar për këtë Bord janë: Arben Canolli, Samir Lleshi, Arben Avdiu, Agim Bivolaku, Nexhat Hasani, Përparim Hoxha, Lulëzim Zeka, Afrore Rudi, Faik Collaku dhe Ismail Kovac.

Bordi i Pavarur për Rishqyrtim e Ankesave është një institucion Kosovar i pavarur i cili merret me rishqyrtimin e vendimeve të Administratës Tatimore të Kosovës nëse Tatimpaguesi është i pakënaqur. Bazuar në Ligjin për Administratën Tatimore, Bordi i Pavarur për Rishqyrtime themelohet sipas Urdhresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2000/7.

Anëtarët e Bordit propozohen nga Qeveria vetëm mbi bazën e aftësisë së tyre për të kryer funksionet dhe emërohen nga Kuvendi. Mandati për secilin anëtar është dy vjet ndërsa gjysma e anëtarëve do të zëvendësohet në fund të çdo viti kalendarik. Ky bord duhet të përbëhet nga një Anëtar Kryesues dhe katërmëdhjetë anëtarëve të tjerë, ku së paku shtatë prej anëtarëve i përkasin komuniteti të biznesit të Kosovës dhe që të gjithë janë të pavarur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Largimi i anëtarëve të Bordit mund të bëhet nga Kuvendi me këshillën e Qeverisë, nëse ai vlerëson se anëtarë është i papërshtatshëm të plotësojë funksionet e tij/saj ose është në pozitë të konfliktit të interesit.

Qeveria ndan mjete për subvencionimin e bujqve dhe për TMK-në

Sipas të dhënave të MBPZHR, në Republikën e Kosovës janë mbjellë 76.074 ha me grurë dhe 2.195 ha me elb, që do të thotë se sipërfaqja totale që ka për t'u korrur këtë vit është 78.269 ha.

Me qëllim të subvencionimit të veprimtarisë bujqësore, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin 08/132, ka ndarë mjete për subvencionimin e derivateve të naftës për korrije shirjet e vitit 2010, në vlerë prej 300 mijë euro. Edhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) me vendim ka ndarë mjete në shumë prej 200 mijë euro për po të njëjtin qëllim. Shuma totale e mjeteve të ndara për subvencionimin e derivateve të naftës për korrije shirjet e vitit 2010 është gjysmë milioni euro. Sipas të dhënave të MBPZHR, në Republikën e Kosovës janë mbjellë 76.074 ha me grurë dhe 2.195 ha me elb, që do të thotë se sipërfaqja totale që ka për t'u korrur këtë vit është 78.269 ha. Përfitues të këtij subvencioni do të jenë të gjithë ata fermer që kanë mbjellë drithëra të bardhë, pasi që përmes këtij subvencionimi çmimi i korrije shirjeve është ulur dhe kostoja e prodhimit të grurit do t'ju kushtojë më lirë fermerëve.

Ndërkaq, Qeveria e Republikës së Kosovës në po këtë mbledhje mori vendim që t'iu vazhdohet

kompensimi ish pjesëtarëve të TMK-së deri në fund të këtij viti në vlerën prej 50% të pagës së tyre bazë. 836 ish pjesëtarë të TMK-së kanë mbetur të pa sistemuar dhe pa punë. Ata kanë qenë të përfshirë në kuadër të pagave të marra nga UNDP-ja, ku me 1 qershor të këtij viti ka skaduar kjo kontratë. Sipas këtij vendimi të Qeverisë pagesa mund t'i ndërpritet çdo ish pjesëtarë të TMK-së në rast të punësimit eventual.

Po të njëjtën mbledhje, para marrjes së vendimeve për subvencionim të bujqve dhe pjesëtarët e TMK, Qeveria e Kosovës morri vendim (vendimi 7/132) se nuk do të zbatohet asnjë iniciativë të re për shpenzime në vitin 2010, e cila nuk është në pajtim me rishikimin e buxhetit të aprovuar për vitin 2010. Në vendim thuhet se rishikimi i buxhetit për vitin 2010 tashmë i adreson nevojat e shpenzimeve aktuale të qeverisë, përderisa për shpenzime të paparashikuara veç është ndarë rezerva financiare.

Merret iniciativë për themelimin e Qendrës për Studime dhe Hulumtime Gjinore

Një qendër e tillë, me të njëjtin emërtim, ekziston edhe në kuadër të shoqërisë civile

Në mbledhjen 133-të (vendimi 09/132), Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim të themelojë grupin punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për themelimin e Qendrës për Studime dhe Hulumtime Gjinore. Në përbërje të grupit janë: Zyra e Kryeministrit; Agjencia për Barazi Gjinore; Ministria e Administratës Publike; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria për Ekonomi dhe Financa; dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Grupi ka për detyrë të hartojë rregulloren e brendshme për formimin dhe funksionimin e Qendrës për Studime dhe Hulumtime Gjinore, brenda një afati kohor prej tre muajsh. Zyra e kryeministrit dhe Agjencia për Barazi Gjinore janë përgjegjëse për administrimin e rregullt dhe funksionimin e grupit punues. Një qendër e tillë, me të njëjtin emërtim, ekziston edhe në kuadër të shoqërisë civile.

Universiteti i Prizrenit lejohet të shpallë konkurs për pranimin e studentëve të rinj

Me vendim numër 06/134, Qeveria i ka dhënë dritën e gjelbër Universitetit të Prizrenit që të shpallë konkurs për pranimin e studentëve për vitin akademik 2010/2011, përderisa vazhdon procedura e akreditimit sipas agjendës së paraparë. Së pari MASHT i kishte lejuar Universitetit të Prizrenit që në vitin e parë akademik të pranojë vetëm 600 studentë, numër ky që u dyfishua me një vendim që e morri Ministri gjatë një vizite bërë këtij universiteti. Në vitin e parë akademik janë pranuar studentë në gjashtë fakultete: administrim biznesi, menaxhment ndërkombëtar, softuer dizajn, teknologji e informacionit dhe telekomunikimit, juridik dhe gjuhë gjermane.

Megjithatë, Universiteti i Prizrenit ende nuk e ka ndërtuar kampusin e tij. Ndërkaq, Qeveria e Kosovës e ka obliguar Ministrinë e Arsimit që të ndajë mjete nga buxheti i Ministrisë për të financuar renovimin e objekteve që do të shfrytëzohen nga Universiteti i Prizrenit. Ministria do të financojë renovimin e këtyre objekteve në bashkëpunim me organizatën turke TIKa. Kjo e fundit do të kontribuojë me 100.000 euro, përderisa Ministria do të ndajë 50.000 euro nga buxheti i saj. Një vendim i tillë është marrë në mbledhjen e 135-të të Qeverisë më 28 korrikut. Qeveria ka ndarë 2 milion euro për Universitetin e Prizrenit, përderisa është paraparë që në vitin 2011 dhe 2012 të ndahen nga 5 milion euro.

Qeveria ende e pa vendosur se si t'ia bëjë me prokurorimin publik

Sipas Projektligjit, kontratat me vlerë të mesme dhe të mëdha do të nënshkruhen edhe nga ministrat apo kryetarët e komunave; Qeveria e Kosovës edhe pse ka miratuar Projektligjin për Prokurim Publik, ende nuk e ka finalizuar përmbajtjen e tij dhe nuk e ka dërguar në Kuvend;

Pas akuzave të shumta për korrupsion dhe pas bastisjeve të bëra nga EULEX në disa dikastere qeveritare, Qeveria e Kosovës ka marrë masa për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik. Hapi i parë për këtë u ndërmor në mbledhjen e 126-të të Qeverisë së Kosovës në muajin maj, kur Qeveria miratoi Udhëzimin Administrativ për Nënshkrimin e Kontratave Publike me Vlerë të Mesme dhe të Madhe. Ky udhëzim administrativ parashihte se përveç zyrtarit të prokurimit, i cili me Ligjin për Prokurim Publik ka përgjegjësinë dhe të drejtën për nënshkrimin e kontratave, tani e tutje kontratat me vlerë mbi 10.000 euro duhet të nënshkruhen edhe nga sekretari i ministrisë dhe ministri (apo kryetari i komunës, në rastin e komunave). Kjo formë e ndryshimit të ligjit nuk ishte konform rregullave ligjore, pasi që me akt nënligjor tentohej të ndryshohej përmbajtja e vetë Ligjit. Sipas informatave nga vetë Zyra e Kryeministrit, ky udhëzim administrativ nuk është hartuar asnjëherë dhe si i tillë nuk ka ekzistuar realisht.

Mirëpo, në mbledhjen e 133-të, të mbajtur më 7 korrik 2010, Qeveria e Kosovës miratoi edhe një herë Projektligjin për Prokurim Publik. Kësaj radhe, ndryshimet e kërkuara dy muaj më parë përmes udhëzimit administrativ,

janë inkorporuar në Projektligj. Projektligji për Prokurim Publik nuk i është dërguar Kuvendit të Kosovës deri në fund të muajit korrik. Arsyeja për këtë vonesë, sipas zyrtarëve të Zyrës së Kryeministrit, është se janë duke u bërë disa ndryshime në draft pas propozimeve të dala nga mbledhja e 133-të. Në këtë mbledhje, me rastin e propozimit të Projektligjit dhe votimit të tij, së paku dy ministra të kabinetit qeveritar nuk janë pajtuar me përmbajtjen e projektligjit. Sipas tyre, nuk ka kuptim që institucionet qeveritare të angazhojnë zyrtarë të prokurimit për të kryer punën e tyre profesionale, dhe në fund të tërë procesit të prokurimit, nënshkrimin ta vendos edhe vetë ministri, i cili mban post politik. GAP ka arrit që të siguroj një kopje të Projektligjit për Prokurim Publik. Ky Projektligj është ende i papërfunduar dhe gjuha bazë e tij është gjuha angleze. Neni 26.2 i Projektligjit bën fjalë për nënshkrimin e kontratave, ku: "Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit kontratat me vlerë të mesme dhe të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, gjegjësisht Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik."

Ndryshimet në procedurat e prokurimit publik, Qeveria është duke i kërkuar dhe për shkak

të kritikave të paraqitura në dy raportet e fundit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën. Mirëpo, obligimi me ligj që kontratat të nënshkruhen nga ministri apo autoriteti tjetër përkatës publik, sërish mund të jetë objekt kritikash i Komisionit Evropian, pasi që një metodë e tillë ndikon në politizimin e procedurave të prokurimit. Nëse Projektligji për Prokurim Publik dërgohet dhe miratohet në Kuvend, atëherë ai do t'i zëvendësojë në tërësi ligjet në fuqi për prokurim publik.

Qeveria ka vazhduar me paqartësi rreth prokurimit publik edhe sa i përket emërimeve në pozita të larta drejtuese në organet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Prokurorimin Publik. Më 2 Korrik 2010, në mbledhjen e 132-të të saj, Qeverisë e Kosovës ka emëruar z. Mursel Racaj Drejtor të Përkohshëm të Agjencionit të Prokurimit Publik. Ky emërim i përkohshëm ka ardh pas dorëheqjes që ka bërë drejtori i përkohshëm Ilir Rama. Që nga viti 2008, Agjencioni i Prokurimit Publik ka funksionuar me drejtor të përkohshëm dhe Qeveria e Kosovës nuk i ka propozuar Kuvendit të Kosovës një emër për drejtor të plotfuqishëm të APP.

Me vendimin 12/132, Qeveria i propozoi Kuvendit të Kosovës z. Osman Kryeziu për anëtar në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Shpronësimi i pronave për ndërtimin e autostradës vazhdon në territorin e komunën e Suharekës

Pas shpronësimit të pronave private në segmentin e autostradës Vërmicë-Prizren, Qeveria ka filluar procesin e shpronësimit të pronave edhe në pjesën e komunës së Suharekës. Me vendimin 10/135, në mbledhjen e saj të rregullt, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim preliminar që për hir të interesit publik të bëjë shpronësimin e pronave të paluajtshme që ndodhën brenda segmentit 3. Këto prona i takojnë zonave kadastrale Trnje, Leshan, Reshtan dhe Suharekë deri te ngastrakadastrale 315. Sipas këtij vendim, Ministria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, brenda pesë dite pune, duhet t'i dërgojnë vendimin preliminar Komunës së Suharekës dhe personave të identifikuar. Kurse, brenda dhjetë

dite punë këto ministri e kanë për obligim të bëjnë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë me tirazhin më të madh në Kosovë. Pronari ka të drejtë të paraqes ankesë brenda tridhjetë ditëve kalendarike në gjykatën kompetente në rast të pakënaqësisë me këtë vendim. Ndërkaq, sa i përket pronave publike që bien në trasenë e autostradës, ato tashmë janë pronë e Qeverisë së Kosovës. Një vendim i tillë e kishte marrë Qeveria më 1 qershor 2010. Një kronologji të vendimeve që kanë të bëjnë me ndërtimin e autostradës mund ta lexoni në GAP Monitorin e muajit qershor 2010.

Po në të njëjtën mbledhje, me anë të vendimit 8/135, Qeveria e Kosovës mori vendim që Ministria e Drejtësisë të

përfaqësojë Qeverinë në të gjitha procedurat gjyqësore përkatëse të shpronësimit. Në këtë vendim po ashtu ceken procedurat të cilat duhet të ndiqen nga ankuesit, procedura të cilat rrjedhin nga neni 35 (4) i Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Parashtruesit e ankesës duhet të sigurojnë që pesë kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Departamentin për Çështje Ligjore – Divizioni për Përfaqësim Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë.

Miratohet Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë.

Qeveria ka miratuar Platformën Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë. Ky vendim u mor në mbledhjen e 133-të. Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë është e mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Platforma vjetore është zhvilluar duke pasur si pikënisje detyrat strategjike në fushën e sigurisë së Kosovës. Pjesë e platformës vjetore janë: ruajtja dhe mbrojtja e sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Kosovës përfshirë mbrojtjen e institucioneve të saj, sigurimin themelor të stabilitetit ekonomik, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, sundimit të ligjit, zhvillimit të demokracisë dhe të institucioneve demokratike, dhënia e kontributit për sigurinë globale, aderimin në institucionet evropiane dhe euroatlantike, sigurimin e stabilitetit dhe paqes në territorin e Evropës juglindore, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të proceseve integruese brenda bashkësisë ndërkombëtare.

Miratohet Projektligji për Markat Tregtare

Ligji 2006/02-L54 për Markat Tregtare i hyrë në fuqi më 28 qershor 2006 do të zëvendësohet me me Projektligjin e ri për Markat Tregtare, të cilin Qeveria e Kosovës e miratoi në mbledhjen e saj të 132-të. Ligji në fjalë përcakton rregullat për mbrojtjen e markave tregtare, mënyrën e fitimit të së drejtës së markës tregtare, procedurat për regjistrim, ndryshimet në marka tregtare, ndërprerjen e vlefshmërisë, anulimin e markave tregtare dhe procedurat tjera lidhur me markat tregtare.

Për më shumë, ky ligj zbatohet për markat tregtare që i nënshtrohen procedurës së regjistrimit në Zyrën për pronësi industriale të Republikës së Kosovës, e themeluar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, përfshirë këtu markat komunitare dhe regjistrimet ndërkombëtare të markës tregtare që vlejnë në Republikën e Kosovës. Data e vlefshmërisë pas regjistrimit të markës tregtare është 10 vite. Në këtë projektligj janë përcaktuar po ashtu dënimet në rastet kur personat fizik dhe juridik, pa autorizim, përdorin një markë tregtare në kundërshtim me nenin 8 të këtij projektligji që përcakton të drejtat ekskluzive të pronarit të markës. Pra, dispozitat ndëshkuese ndaj personit juridik që bënë shkelje të tillë variojnë prej 5.000 – 15.000 euro. Ndërkaq, për personat fizik, masat ndëshkuese variojnë prej 500 – 1.500 euro.

U miratuan tri udhëzime administrative në kuadër të Ligjit për Menaxhimin e Integruar Kufitar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror

Këto tri udhëzime administrative të miratuara nga Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 135-të, dalin nga Ligji për Menaxhimin e Integruar Kufitar dhe Kontrollin e Integruar Shtetëror, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 21 maj 2008.

Në mbledhjen e saj të rregullt, të 135-të, të radhës, e cila u mbajt më 28 korrik 2010, Qeveria miratoi Udhëzimin Administrativ për Shënjimin e Vijës Kufitare bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, gjegjësisht Nenin 7 ku flitet për shënimin e vijës kufitare. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i mënyrës së shënjimit dhe mirëmbajtjes së kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me marrëveshjet ekzistuese ndërkombëtare. Gjithashtu, në këtë udhëzim administrativ është përkufizuar vija kufitare gjegjësisht, toka e Kosovës, pjesa e ujërave ndërkufitare të cilat i takojnë Kosovës, nëntoka dhe hapësira ajrore. Në këtë udhëzim administrativ përkufizohen po ashtu kompetencat për shënjimin e vijës kufitare e cila duhet të bëhet nga komisionet ndërshtetërore nga të dyja palët që i ndanë kufiri.

Po ashtu në të njëjtën mbledhje me vendimin 05/135, u miratuar edhe udhëzimi tjetër administrativ në kuadër të Ligjit për Menaxhimin e Integruar Kufitar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, gjegjësisht Nenit 10 të këtij ligji që përcakton përgjegjësinë për trajtimin e incidenteve

kufitare. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i mënyrës së raportimit, hetimit dhe zgjidhjes së incidenteve kufitare. Për më shumë, në raste të shkeljes së pacenueshmërisë së kufirit shtetëror të kryer nga organet shtetërore të huaja apo zyrtarët shtetëror të huaj, organet kompetente duhet të ndërmarrin menjëherë të gjitha masat për hetimin e tyre si dhe më pas të raportojnë tek organet kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe tek Ministria e Punëve të Jashtme. Ndërkaq, sa i përket trajtimit të incidente kufitare, ato duhet të bëhen përmes negociatave në mes të autoriteteve kompetente të të dyja vendeve, përmes kanaleve diplomatike si dhe përmes punës së komisioneve të përbashkëta të përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare.

Dhe së fundi me vendimin 06/135, duke u bazuar në Ligjit për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, përkatësisht Nenit 20 që përcakton procedurat për ndërtimin dhe vendosjen e objekteve në zonën e kalimit kufitar, u miratua edhe Udhëzimin Administrativ për Ndërtimin e Ndërtesave Brenda Zonës së Kalimit të Kufirit. Me këtë udhëzim përcaktohen

procedurat e veçanta për miratimin e lejes për ndërtimin e objekteve, ndryshimin e qëllimit të tyre dhe vendosjen e lehtësirave brenda zonës së kalimit të kufirit shtetëror. Zonat e kalimit kufitar duhet të planifikohen, ndërtohen dhe organizohen në mënyrë që të mundësojnë kryerjen e sigurt, të vazhdueshme dhe me shpenzime efektive të detyrave të kontrollit të kufirit shtetëror. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për planifikimin, ndërtimin dhe organizimin e zonave të kalimit të kufirit shtetëror, në konsultim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit si dhe të agjencive tjera të përfshira në punën kufitare.

Investitori apo zyra projektuar është e obliguar që para dorëzimit të kërkesës për projektin ndërtues tek organi kompetent për lëshimin e lejeve të nevojshme, të siguroj miratimin nga ana e MPB-së. Kërkesa nuk duhet të miratohet nëse lehtësirat, pajisjet ose mjetet e tilla, apo aktivitetet e tjera që do të kryhen, pengojnë kryerjen e vazhdueshme të kontrollit kufitar dhe masat e sigurisë në zonën e kontrollit kufitar.

Miratohet Koncepti i Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike

Në mbledhjen e 135-të të Qeverisë së Kosovës, me vendimin 07/135, u miratua Koncepti i Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike. Ky dokument është përgatitur nga Grupi Punues i Modelit të Tregut formuar në bazë të vendimit të Qeverisë 7/125 i 18 majit 2010 nën drejtimin e politikave nga Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Qeverisë së Kosovës.

Qeveria pati kërkuar që të përgatitet dhe t'i dorëzohet Qeverisë një koncept i modelit të rishqyrtuar të tregut kalimtar, i cili siguron zbatimin e suksesshëm të Projektit të Termocentralit Kosova e Re, privatizimin e suksesshëm të KEDS-së, po ashtu të jetë në përputhje me Strategjinë e Energjisë 2009 – 2018 dhe të mundësojë zhvillimin e projekteve të ardhshme të gjenerimit si dhe të jetë në përputhje me obligimet e Kosovës para Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Autorët kanë identifikuar tri çështje që duhen trajtuar në ndërtimin e një modeli të duhur për sektorin e energjisë së Kosovës: gjendjen aktuale të sektorit të energjisë e cila përballlet me sfida e kërcënime

të shumta por me forca dhe mundësi përmirësimi; gjendja e dëshiruar e sektorit të energjisë, gjendje e cila është fizikisht e sigurt dhe në gjendje të përforcojë sigurinë e furnizimit elektrik për të mbuluar kërkesat e konsumatorëve të Kosovës gjatë gjithë kohës në mënyrë të përgjegjshme në kuptimin mjedisor, me çmime të arsyeshme, si dhe në pajtim me politikat qeveritare, përfshirë edhe pajtueshmërinë me obligimet e Kosovës në Traktatin e Komunitetit të Energjisë si dhe ligjet e Kosovës; dhe drejtimi më i mirë i kalimit nga gjendja aktuale tek gjendja e dëshiruar.

Së fundi, me këtë koncept do të synohet që të arrihen synimet imediate të trajtimit të synimeve fizike, financiare/komerciale si dhe politikat qeveritare për sektorin elektrik të Kosovës, si dhe të ofrohet një drejtim i qartë për Modelin e Tregut Elektrik të Kosovës (VMTEK) pas arritjes së kushteve të dhëna, të cilat do të mundësonin një kalim të mëtutjeshëm tek VMTEK-ja.

Emërohet këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

Në mbledhjen 135, me vendimin Nr. 13/135, Qeveria ka aprovuar Këshillin Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në këtë përbërje: Ferdiqe Zhuzhi (MASHT), Avdullah Alija (MASHT), Edita Krasniqi (MPMS), Petrit Gashi (MTI), Menderes Ibra (MEF), Arberesha Turjaka (MSH), Tahir Arbnesi (UP), Ilir Ibrahim (AUK), Hivzi Dragidella (Oda Ekonomike), Anton Gojani (Don Bosko), Agim Shahini (Aleanca Kosovare e Biznesit), Bedri Xhafa (Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë), Agron Zenelaj (Hendikos).

Ky këshill duhet ta zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin, kurse duhet të mblidhet së paku gjashtë herë në vit. Funksionimi i këtij Këshilli parashihet me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 7 nëntor 2008.



MFSK dhe FSK me strukturë të re

Sipas kësaj strukture, personeli civil dhe ushtarak do të jetë në përbërje prej gjithsejtë 201 personave. Nga ky numër, 125 do të përbëhen nga stafi civil si dhe 67 në FSK.

Në kuadër të konsolidimit të institucioneve civile dhe ushtarake të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë së Forcës së Sigurisë si dhe Forcës së Sigurisë, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 135-të, të mbajtur më 28 korrik 2010, ka miratuar propozimin e kësaj të fundit për strukturën e re.

Sipas kësaj strukture, personeli civil dhe ushtarak do të jetë në përbërje prej gjithsejtë 201 personave. Nga ky numër, 125 do të përbëhen nga stafi civil si dhe 67 në FSK. Në strukturën e Ministrisë, përpos ministrit dhe zëvendësministrave, personeli – stafi politik do të përbëhet nga 9 persona. Ndërkaq stafi administrativ do të ketë gjithsejtë 125 punëtorë. Kabineti i Ministrit do t'i ketë gjithsejtë 5 punëtorë, dhe 6 këshilltarë politik, ndërkaq zëvendësministri

nga 3 punëtorë. Sekretari i përgjithshëm do t'i ketë 4 punëtorë dhe do t'i ketë nën udhëheqje të drejtpërdrejtë 8 njësi, departamente apo zyre. Drejtoria për Politikë dhe Plane do të përbëhet nga 5 departamente. Në kuadër të kabinetit të ministrit do të jetë dhe zyra për informim publik dhe zyra e inspektorit të përgjithshëm të FSK-së. Po ashtu, paralelisht me Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, nën udhëheqjen e Ministrit do të jetë dhe zyra e Komandantit të FSK—së që do të ketë përgjegjësinë për udhëheqjen e Komandës së Forcave Tokësore. Nën komandën e Komandantit të FSK-së, do të jetë dhe Drejtoria për Operacione që do të përbëhet nga 5 departamente.

Është miratuar Plani i Veprimit të Strategjisë për Rikthimin e Personave të Riatdhesuar

Vetëm në gjashtë muajt e parë të këtij viti në mënyrë vullnetare janë kthyer rreth 1 mijë persona, ndërkaq janë depërtuar 1 mijë e 500 të tjerë dhe deri në fund të këtij viti pritet të kthehen edhe 5 mijë persona të tjerë, të cilët nuk kanë leje qëndrimi.

Pas miratimit të Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar në maj të këtij viti, këtë muaj ka miratuar edhe Planin e saj të Veprimit, përmes së cilit parashihen të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren nga ministritë dhe niveli komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Për implementimin e planit të veprimit janë siguruar edhe mjetet financiare, ku Qeveria ka marrë vendim për themelimin e një fondi inicial, ndërsa donatorët nga shtetet që riatdhesojnë kanë shprehur interesimin për të kontribuar në këtë fond.

Procesi i riatdhesimit, paraqet një sfidë për institucionet shtetërore, andaj kthimi do të bëhet në grupe të vogla, pasi që Kosova ka kapacitete të vogla absorbuese për pranimin e të gjithë atyre shtetasve, të cilët qëndrojnë ilegalisht nëpër shtetet e ndryshme evropiane.

Gjithashtu, procesi i riatdhesimit do ta rëndojë fuqishëm gjendjen ekonomiko-sociale në Kosovë, edhe përkundër stimulimit që do marrin nga shtetet që do ta bëjnë kthimin e personave që qëndrojnë në të "zezë" në Evropë, në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për t'u ofruar ndihmë personave të riatdhesuar, ndihma e vetme e ofruar nga Buxheti i Kosovës është ndihma njëjavore deri sa të

strehohen si dhe skema sociale. Vetëm në gjashtë muajt e parë të këtij viti në mënyrë vullnetare janë kthyer rreth 1 mijë persona, ndërkaq janë depërtuar 1 mijë e 500 të tjerë dhe deri në fund të këtij viti pritet të kthehen edhe 5 mijë persona të tjerë, të cilët nuk kanë leje qëndrimi. Përderisa në vitet e ardhshme parashikohet që të riatdhesohen rreth 15 mijë shtetas kosovarë, ku vetëm nga Gjermania pritet të kthehen rreth 14 mijë e 900 persona, kurse Zvicra dhe vendet e tjera evropiane kanë një numër më të vogël të shtetasve të Kosovës. Për zbatimin e kësaj strategjie Qeveria e Kosovës për vitin 2010, ka ndarë 500.000 euro kurse për vitin 2011 ka zotuar 3.500.000 euro shtesë për implementimin e saj.

Deri më tani janë nënshkruar marrëveshje për riatdhesim me Shqipërinë, Francën, Zvicrën, Gjermaninë dhe Belgjikën. Marrëveshje të tilla pritet që të nënshkruhen edhe me Norvegjinë, Austrinë, Holandën dhe Luksemburgun, ndërkaq zyrtarë qeveritarë konfirmojnë se ftesat për fillimin e negociatave për Marrëveshjet e ripranimit u janë dërguar: Britanisë së Madhe, Bullgarisë, Çekisë, Estonisë, Finlandës, Irlandës, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Portugalisë, Sllovenisë, Suedisë dhe Hungarisë.

Përmbledhje

Më poshtë kemi radhitur të gjitha vendimet e marra nga Qeveria gjatë muajit korrik 2010 (mbledhjet 132-135):

Vendimet nga mbledhja e 132-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 2 korrik 2010:

1. Vendimi 02/132, miratohet Projektligji për Tregtinë e Mallrave Strategjike;
2. Vendimi 03/132, ndryshohet dhe Plotësohet Strategjia Legjislative 2010. Nga SL '10 shlyhet Projektligji për Kontrollin e Eksportit;
3. Vendimi 04/132, miratohet Projektligji për Markat Tregtare;
4. Vendimi 05/132, miratohet Projektligji për Inspektoratin Policor të Kosovës;
5. Vendimi 06/132, Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit Anëtarët e Bordit të Rishqyrtimit të Ankesave;
6. Vendimi 07/132, Qeveria e Kosovës nuk do të zbatoj asnjë iniciativë të re për shpenzime në vitin 2010 e cila nuk është në pajtim me rishikimin e buxhetit të aprovuar për vitin 2010;
7. Vendimi 08/132, ndahen mjete financiare në vlerë prej 300.000 euro për subvencionimin me derivate të naftës për korrje-shirje për vitin 2010;
8. Vendimi 09/132, themelohet Grupi punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për themelimin e Qendrës për Studime dhe Hulumtime Gjinore;
9. Vendimi 10/132, iu vazhdohet pagesa 863 ish pjesëtarëve të TMK-së sipas listës së bashkangjitur, për gjashtë muajt e ardhshëm, në shumën prej 50% të pagës bazë të cilën e kanë gëzuar deri më 31 maj 2010;
10. Vendimi 11/132, Qeveria e Republikë së Kosovës emëron Drejtor të Përkohshëm të Agjencionit të Prokurimit Publik z. Mursel Racaj.
11. Vendimi 12/132, Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë në Organin Shqyrtues të Prokurimit i Propozon Kuvendit të Kosovës z. Osman Kryeziu.

Vendimet nga mbledhja e 133-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 7 korrik 2010:

1. Vendimi 01/133, ndryshohet dhe Plotësohet Strategjia Legjislative për vitin 2010. Në SL '10 shtohet Projektligji për Prokurim Publik në Kosovë;
2. Vendimi 02/133, miratohet me vërejtje Projektligji për Prokurim Publik në Kosovë;
3. 2.3 Vendimi 03/133, miratohet Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë.

3. Vendimet nga mbledhja e 134-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 14 korrik 2010:

1. Vendimi 01/134, miratohet Plani Hapësinorë i Kosovës 2010-2020;
2. Vendimi 02/134, miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës;
3. Vendimi 03/134, Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit emra për Anëtarë të Bordit në Agjencionin Kosovar të Privatizimit;
4. Vendimi 04/134, akreditohet Universiteti i Prishtinës në nivel institucional;
5. Vendimi 05/134, akreditohen programet e disa prej BPrAL;
6. Vendimi 06/134, universiteti i Prizrenit mund të shpall konkurs për pranimin e studentëve në vitin akademik 2010-2011përderisa vazhdon procedura e akreditimit sipas agjendës së paraparë;

Vendimet nga mbledhja e 129-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 15 qershor 2010:**Vendimet nga mbledhja e 135-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 28 korrik 2010:**

1. Vendimi 02/135, kërkohet nga Komisioni Qeveritar për Privatizimin e PTK-së, të vazhdojë me procedurat e privatizimit të Post-Telekomunikacionit të Kosovës Sh.A. (PTK) duke inkorporuar rekomandimet e dala nga mbledhja e Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 27 korrik 2010;
2. Vendimi 03/135, ndryshohet dhe plotësohet Strategjia Legjislative për vitin 2010, shtohet Projektligji për Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim dhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Policinë;
3. Vendimi 04/135, miratohet Udhëzimi Administrativ për shënjimin e vijës kufitare;
4. Vendimi 05/135, miratohet Udhëzimi Administrativ për incidentet kufitare;
5. Vendimi 06/135, miratohet Udhëzimi Administrativ për ndërtimin e ndërtesave brenda zonës së kalimit të kufirit;
6. Vendimi 07/135, miratohet Koncepti i Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, sipas propozimit të grupit punues;
7. Vendimi 08/135, obligohet Ministria e Drejtësisë për përfaqësimin e Qeverisë në procedurat gjyqësore përkatëse të shpronësimit;
8. Vendimi 09/135, miratohet struktura e re e Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës;
9. Vendimi 10/135, merret vendim preliminar për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit në pronat e paluajtshme që ndodhën brenda segmentit 3, përkatësisht në pjesët e zonave kadastrale Trnje, Leshan, Reshtan dhe Suharekë deri te ngastra kadastrale 315;
10. Vendimi 11/135, miratohet Plani i Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar;
11. Vendimi 12/135, ndahen mjete financiare në vlerë prej 150.000 euro për bashkëfinancimin e renovimit të objekteve të Universitetit të Prizrenit me organizatën turke TIKa, e cila do të kontribuoj me shumën prej 100.000 euro;
12. Vendimi 13/135, emërohet Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

gap monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Rr. Nëna Terezë 41/29
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 38 224 145
monitor@insitutigap.org
www.institutigap.org

"GAP Monitor" është projekt i Institutit për Studime të Avancuara GAP në të cilin monitorohen vendimet e Qeverisë së Kosovës. Projekti i "GAP Monitor" ka filluar në janar të 2009, ku përmes publikimeve të përmuajshme Instituti GAP i ofron publikut informata dhe analiza më të thella për të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Tani, projektit të "GAP Monitor" është shtuar edhe faqja e re në internet, e cila na mundëson interaktivitet më të madh me lexuesit si dhe mundësinë për të publikuar lajme dhe analiza në kohë më të shpejtë.


INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Të gjitha raportet për vendimet e Qeverisë mund të gjenden edhe në portalin e GAP Monitor në internet **www.gapmonitor.org**

Instituti për Studime të Avancuara GAP
përkrahet nga:



Projekti i GAP Monitor
përkrahet nga:

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.